

Komuna e Obiliqit 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

Hyrje

Obiliqi udhëhiqet nga Xhafer Gashi i cili përfaqëson Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Ky është mandati i tij i parë. Gashi ka fituar në balotazh ndaj Mehmet Krasniqit nga Lidhja Demokrtike e Kosovës. Ky i fundit në raundin e parë ka marr 3,578 vota (apo 31%), ndërsa Gashi ka pasur 3,088 vota (26%). Në balotazh Gashi ka dalë fitues me 5,380 vota (54%).¹

Hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.² Sipas një studimi të UNDP-së, 90% e qytetarëve të Obiliqit konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.³ Dy vite pas nisjes së mandatit të kryetarit Gashi, 30% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e tij, përderisa vetëm 34% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.⁴

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Obiliqit. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: ndotja e ambientit, deponia e mirashit, problemet me mungesën e ujit të pijes, mungesa e hapësirave të gjelbëruara, mungesa e shkollës në fshatin Leshkoshiq dhe fshatin

¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 20 qershor 2017) Rezultatet për Balotazh. Burim: <http://bit.ly/2szzr1OU> (Qasur më 18.06.2017)

² Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU> (Qasur më 18.06.2017)

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

Babimoc, ndotja e lumenjve, mungesa e shtëpisë së Kulturës si dhe Qendrës Rinore.⁵

Problemet aktuale të Komunës së Obiliqit

Ndotja e ajrit

Ky problem ka ekzistuar edhe para zgjedhjeve lokale të vitit 2013. Ndotja e ajrit vazhdon të konsiderohet nga banorët e Obiliqit si një nga problemet madhore që ka kjo komunë. Në hulumtimin e zhvilluar nga UNDP “Mozaiku i Kosovës” problemi i ndotjes së ajrit është vlerësuar shqetësim nga afro 88% e qytetarëve të Obiliqit.⁶ Shkalla e lartë e ndotjes vjen nga operimi i dy termocentraleve me bazë qymyri të cilat shkaktojnë ndotje të madhe. Andaj, si pasojë e kësaj ndotje, shkaktohen dëme të mëdha në ambient, kontaminim të tokës, ajrit, ujit dhe ndikime negative në shëndet. Shumë banorë që jetojnë përreth termocentraleve ankojnë nga sëmundje të ndryshme të frymëmarrjes, kancerit, sëmundje kardio-vaskulare, sëmundje të syve, etj. Ndotja e ajrit dhe nevoja për shërbime shëndetësore të banoreve ka qenë arsyeja kryesore që e ka shtyrë legjislativin e Kosovës të miratojë Ligjin për Obiliqin me qëllim të ndërmarrjes së masave ndër institucionale për të ndihmuar këtë komunë në përbalimin e kësaj gjendje.⁷

Deponia e Mirashit

Edhe ky problem është cekur në vitin 2013. Kjo deponi e mbeturinave është regjionale dhe mbeturinat sillen nga Prishtina, Podujeva, Lipjani, Graçanica, Fushë Kosova dhe Drenasi. Deponia lëshon erëra të rënda dhe ndikon negativisht në gjendjen e ambientit. Kjo është konstatuar edhe nga ana e eksperteve të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë. Në pjesën dërmuese të kohës, mbeturinat digjen duke shkaktuar tym të dendur. Komuna e Obiliqit ka kompetenca për të obliguar përgjegjësit e deponisë që shkalla e mirëmbajtjes së saj të brendshme të jetë në përputhje me standardet e kërkuara duke pamundësuar kështu ndezjen e mbeturinave dhe shpërndarjen e tyre jashtë diametrit të deponisë.

Derdhja e kanalizimeve në lumë

⁵ Instituti GAP, Komuna e Prizrenit: Problemet kryesore dhe trendët buxhetore. Shtator 2013. Burimi: <http://bit.ly/2rUyJB0>

⁶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 15.

⁷ Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale.

Në Komunën e Obiliqit gjenden tre lumenj, lumi "Sitnica", lumi "Llap" dhe lumi "Drenica". Lumi "Sitnica" ka gjatësinë më të madhe në këtë komunë. Lumenjtë janë të ndotur nga hedhja e mbeturinave dhe veçmas derdhja e kanalizimeve në rrjedhën e tyre. Era e keqe që përhapet shqetëson një numër të madh të banorëve, veçmas përgjatë zonave Plemetin, Bellacerkë, Sibovc, Hamidi dhe Dobrosellë. Autoritetet komunale nuk kanë ndonjë plan për trajtimin e ujërave të zeza dhe pamundësinë e derdhjes së tyre në lum.

Çrregullimet e orarëve në transportin publik

Në komunën e Obiliqit operojnë dy operatorë të licencuar nga komuna për të mbajtur linjën e transportit të udhëtarëve në relacionin Prishtinë-Obiliq dhe anasjelltas. Komuna nuk ka hartuar një orar të qarkullimit të tyre dhe kjo gjendje shfrytëzohet nga këta operatorë për t'i nisur autobusët vetëm në periudha kur përgjegjësit e tyre konsiderojnë që është në favor të biznesit. Kjo gjendje bën që shpesh herë në të njëjtën kohë të qarkullojnë autobusët e të dy operatorëve dhe po ashtu janë të shuma rastet kur udhëtarëve u bie të presin shumë për shkuarjen ose ardhjen në relacionin Prishtinë-Obiliq.

Mungesa e investimeve në stadiumin e qytetit

Komuna e Obiliqit e ka të trashëguar një stadium në qytet i cili mban emrin e dëshmorit "Agron Rama". Asetet e stadiumit nuk i janë nënshtruar asnjëherë ndonjë investimi publik, për rrjedhojë stadiumi duket i dëmtuar në shumë pjesë dhe nuk plotëson kushtet për ushtrimin e veprimtarive të sportit. Komuna gjatë këtyre viteve nuk ka paraparë ndonjë investim. Përveç kësaj, në zonën ku është stadiumi mungon ndriçimi publik si dhe rrjeti i kanalizimit.⁸

Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje

Ekspozimi i mallrave ushqimore në rrugë

Komuna e Obiliqit konsiderohet si njëra ndër komunat me shkallën më të lartë të ndotjes së ajrit. Në këtë komunë në gjitha pjesët e qytetit vërehen mallra ushqimore të ekspozuara në hapësira të hapura. Komuna duhet të ndërmerret masa me qëllim të rregullimit të kësaj fushe dhe parandalimin e sëmundjeve që mund të vijnë si rezultat i kontaminimit të ushqimit.

Gëlqerosja e ndërtesave përgjatë rrugës kryesore në Obiliq

Rruga kryesore në Obiliq (jo larg objektit të komunës) përshkohet me disa ndërtesa pesë kateshe të cilat janë në gjendje shumë të keqe


⁸ Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të zhvillimeve lokale.

infrastrukturore. Komuna me qëllim të përmirësimit të pamjes së qytetit duhet të ndërmarr masa duke gëllqerosur këto ndërtesa.

Trendet buxhetore në Komunën e Obiliqit (2017)

Komuna e Obiliqit në vitin 2017 ka planifikuar rreth 6.1 milion euro buxhet. Ndërsa përveç planifikimit të rregullt buxhetor, Komuna e Obiliqit ka bartur të hyrat vetanake nga viti i kaluar rreth 162 mijë euro, kurse në vitin 2013 ishin bartur 483 mijë euro. Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Obiliqit ka pasur një rritje afro 1.5 milionë euro të buxhetit. Krahasuar me buxhetin e vitit 2017 me kohën e zgjedhjeve të fundit (2013) rritja e buxhetit është bërë në kategorinë e pagave, por ka pasur rritje të buxhetit në investime kapitale dhe në mallra dhe shërbime. Kështu, buxheti për paga është ngritur për rreth 844 mijë euro (apo 30%), ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale buxheti është ngritur afro 492 mijë euro (apo 34%).


Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Obiliqit 2017



Komuna e Obiliqit vazhdimisht ka pasur një dominim të shpenzimeve në paga dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, kryesisht gjatë viteve të fundit është shënuar rritje, por jo rritje e madhe.


Ndërsa krahasuar me vitin 2013, numri i të punësuarve në Komunën e Obiliqit është rritur për 44 persona në vitin 2016. Përveç numrit të rregullt të punëtorëve, në komunë janë punësuar edhe 11 persona me kontratë për shërbime të veçanta gjatë vitit 2016.

Figura nr.2: Trendet buxhetore në Komunën e Obiliqit 2013-2017



Komuna e Obiliqit gjatë vitit 2016 ka shënuar regres në shkallën e të hyrave komunale krahasuar me vitin 2015. Kësisoj, në 2016 janë realizuar të hyra në vlerë prej 782 mijë euro, ndërsa një vit më herët shkalla e të hyrave pati kaluar 1 milion euro.

Tabela nr.3: Të hyrat komunale 2013-2016



Burimi: Zyra e Auditorit të Përgjithshëm



Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerret këto veprime:

- Komuna e Obiliqit duhet të rrisë aktivitetin në terren me qëllim të sigurimit të rritjes së të hyrave komunale.
- Komuna e Obiliqit duhet të sigurojë mjete nga buxheti i saj, nga donatorët ndërkombëtarë dhe nga Qeveria e Kosovës për të nisur projektin e trajtimit të ujërave të zeza të cilat kryesisht derdhen në lumenjtë që përshkojnë këtë komunë.
- Komuna e Obiliqit duhet t'i rrisë investimet me qëllim të rritjes së hapësirave sportive dhe rekreative për të rinjtë.
- Komuna e Obiliqit duhet të rrisë numrin e operatoreve privat për bartjen e udhëtareve në relacionin Obiliq-Prishtinë dhe anasjelltas.
- Komuna e Obiliqit duhet të përpilojë orarin e qarkullimi të autobusëve në relacionin Prishtinë-Obiliq dhe anasjelltas.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world